



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2026

VENDIM

Nr. 124, datë 11.03.2026

PËR

**NGRITJEN NË DETYRËN E GJYQTARIT TË GJYKATËS SË POSAÇME
TË SHKALLËS SË PARË PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR
TË ZNJ. MARINELA OSMANI**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 4, të nenit 135, pikën 1, të nenit 147, në shkronjën “a”, pika 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pikën 3, të nenit 104, të Kodit të Procedurave Administrative, në shkronjën “ç”, të nenit 86 dhe nenit 97 e 98, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në pikën 10, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin e tij nr.70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, në përfundim të procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e tij nr. 499, datë 21.11.2022, mbi propozimin e relatorit të procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve,

VENDOSI:

1. Ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të znj. Marinela Osmani.
2. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë më datë 12.03.2026.
3. Një kopje e vendimit i njoftohet znj. Marinela Osmani sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR